

SHOQERISE "TEKNOMEDIA" SH.P.K.

TIRANE

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR

MBI PASQYRAT FINANCIARE

VITI USHTRIMOR FINANCIAR 1 JANAR - 31 DHJETOR 2007

Audituar nga:

Azem HYKAJ, Ekspert Kontabel i Autorizuar

**AZEM HYKAJ
EKSPERT-KONT-AUTORI
NR. L.I.C. 41 SHQI -ALBA**

Raport i Audituesit te Pavarur Mbi Pasqyrat Financiare
(Per Vitin Ushtrimor Financiar 1 Janar deri 31 Dhjetor 2007)

Shoqerise "TEKNOMEDIA" sh.p.k.

Tirane

Une kam audituar pasqyrat financiare te shoqerise "**TEKNOMEDIA**" sh.p.k. **Tirane**, te cilat perbehen nga bilanci kontabel i dates 31.12.2007 bashkelidhur, pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimit ne kapitalet e veta dhe pasqyra e flukseve te parave si dhe nje permbledhje e metodave te rendesishme kontabel dhe shenimeve te tjera anekse.

Pergjegjesite e Drejtimit per Pasqyrat Financiare.

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me ligjin "Mbi Kontabilitetin" dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit si dhe me kuadrin tjetër ligjor te zbatueshem per raportimin financiar. Kjo pergjegjesi perfshine: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali materjale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtateshme kontabel; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjesia e audituesit

Pergjegjesia e ime eshte te shpreh nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tim. Auditimi u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte nderkombetare respektojne kerkesat e etikes, planifikimit dhe kryerjes se auditimit per te marre siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materjale. Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurale per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire ketu edhe vleresimin e rreziqeve te anomalive materjale ne pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtateshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjirtheshme te pasqyrave financiare.


Une besoj qe evidenca e auditimit qe une kam marre eshte e mjaftueshme dhe pershtateshme per te dhene bazat e opinionit tim te auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per gjendjen financiare te shoqerise "**TEKNOMEDIA**" sh.p.k., **Tirane** me date 31 Dhjetor 2007, te rezultatit te saj financiar dhe te flukseve te parave per vitin e mbyllur, ne pajtim me Ligjin "Per Kontabilitetin" dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe respektojne kerkesat e Ligjit "Per Shoqerite Tregtare" e te akteve qe rregullojne themelimin dhe veprimtarine e shoqerise.

Tirane me _____.____. 2008

Audituar nga :
Ekspert Kontabel i Autorizuar
Azem HYKAJ



AZEM HYKAJ
EKSPERT KONT. AUTORI
NR. LIC. 41SHQI -ALBA

Shoqëria "TEKNOMEDIA" sh.p.k. TIRANE

Gjendjet Financiare te Llogarive Vjetore
 (Per Vitin Financiar Ushtrimor te Mbyllur me 31 Dhjetor 2007)

Emertimi	31.12.2007	31.12.2006	Ndryshimi
Aktivi			
<i>I- Aktive te Qendrueshme te Trupezuara</i>	20.536.780	14.578.424	5.958.356
-Ndertime	-	-	-
-Instalime tenike, makineri e paisje	29.162.074	18.422.024	10.740.050
-Mjete transporti	-	-	-
-Amortizimi (viti 2006 eshte 3.483.600 dif.360.000)	(8.625.294)	(3.843.600)	(4.781.694)
<i>II- Aktive Qarkulluese</i>	1.759.225	6.769.975	- 5.010.750
-Kliente	-	5.419.300	- 5.419.300
-Te tjera kerkesa – Tatim Fitimi	1.424.739	1.185.812	238.927
-Likuiditete gjithsej	334.486	164.863	169.623
– Banka	334.486	164.863	169.623
- Arka	-	-	-
Totali i Aktivit	22.296.005	21.348.399	947.606
Pasivi			
<i>Kapitalet e Veta</i>	8.277.625	7.023.479	1.254.146
-Kapitali i nenshkruar	3.895.697	3.895.697	-
-Rezervat	2.445.844	2.445.844	-
Nga keto: - Rezerva statutore	134.000	134.000	-
- Rezerva te tjera	2.311.844	2.311.844	-
-Fitime e humbje (-) te mbartura	681.938	-	681.938
-Fitime e humbje (-) te ushtrimit	1.254.146	681.938	572.208
<i>Detyrime</i>	14.018.380	14.324.920	- 306.540
-Furnitore	8.351.482	8.726.244	- 374.762
-Personeli	-	-	-
-Sigurime shoqerore	91.907	39.151	52.756
-Shteti-tatim taksa - TAP	16.936	1.470	15.466
-Ortake	5.558.055	5.558.055	-
Totali i Pasivit	22.296.005	21.348.399	947.606

Shenim: -Raporti i paraqitur eshte mbeshtetur mbi keto te dhena

Shoqeria "TEKNOMEDIA " sh.p.k. Tirane

Pasqyra e Llogarise se Fitimeve dhe Humbjeve

Per Vitin Ushtrimor Financiar 1 Janar deri 31 Dhjetor 2007

Pershkrimi	Ushtrimi 01.01 -31.12.2007	Ushtrimi 01.01-31.12.2006
A - Te Ardhurat		
-Te tjera shitje e sherbime	17.399.412	22.905.135
-Te ardhura te tjera rrjedhese	-	-
Totali i te ardhurave	17.399.412	22.905.135
B – Shpenzimet		
-Materjale te para e materjale te tjera	-	-
-Furnitura, nentrajtme dhe sherbime	5.130.292	14.455.666
-Shpenzime per personelin	3.340.203	1.955.730
Nga Keto: - Paga	2.744.638	1.535.000
- Sigurime shoqerore	595.565	420.730
-Tatime e taksa dhe te ngjashme	600.000	-
-Shpenzime tjera rrjedhese (qera e te tjera)	1.202.466	-
-Amortizime	5.141.694	1.144.600
-Shpenzime financiare	17.074	-
Totali i Shpenzimeve	15.831.729	22.028.309
C – Rezultati i Ushtrimit		
-Fitimi ose humbja (-) para tatimit	1.567.683	-
-Tatimi mbi fitimin	313.537	194.888
-Fitimi ose humbja neto (-) e bilancit	1.254.146	681.938

Shenim: -Raporti i paraqitur eshte mbeshetur mbi keto deklarime te shoqerise.

-Ne aktiv te bilancit amortizimi i mbartur eshte me i madh 360.000 leke e per rrjedhoje shtesa e amortizimit del 4.781.694 leke.

Shoqeria "TEKNOMEDIA" sh.p.k. Tirane

Pasqyra e Flukseve te Parave

(Hartuar Sipas Metodes Indirekte)

Per Ushtrimin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2007

<u>Faktoret</u>	<u>Efektet + ose (-)</u>
1-Shtesa e kapitaleve te veta te shoqerise	1.254.146 leke
2-Amortizimi	5.141.694 leke
3-Ndryshimi i gjendjeve te inventarit e ne proces	-
4-Ndryshimi i kerkesave mbi debitorët (paksim)	5.180.373 leke
5-Ndryshimi i detyrimeve (paksim)	(306.540) leke
<hr/>	
6-Ndrysh. Gjend. se parave qe rrjedh nga aktivitet. operativ (1 - 5)	11.296.673 leke
7-Shtesa e aktivevet te qendrueshme	(10.740.050) leke
<hr/>	
8-Shtesa e gjendjes se parave (6+7)	529.623 leke
(Sipas bilancit eshte 169.623)	
9-Gjendja e parave ne fillim te vitit	164.863 leke
10-Gjendja e parave ne fund te vitit (10-9) (diference 360.000 leke)	334.486 leke

Shenim: Pasqyra eshte hartuar duke u mbeshtetur mbi deklarimet e pasqyrave financare te shoqerise.

Raport i Pergjithshem i Auditit te Pavarur Mbi Pasqyrat Financiare

Per Vite Ushtrimor Financiar 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2007

Paraqitje e Pergjitheshme e Shoqerise

Shoqeria "TEKNOMEDIA" sh.p.k.. Tirane eshte krijuar dhe e rregjistruar si person juridik me te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr.16305 date 14.11.1996 fillimisht me emrin "YOKOHASAKI LTD" sh.p.k. dhe ka ndryshuar pronesi dhe emer me vendimet e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.16.305/2 dhe nr. 16.305/5 perkatesisht date 30.04.2003 dhe 27.11.2003. Aktualisht ortak dhe pronar i vetem eshte shoqeria "5 Shqiptare" sh.a.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Kapitali i themeltar i shoqerise eshte 3.895.697 leke.

Selia e shoqerise eshte ne Rrugen "Lazgush Poradeci", Pallati i Ri (prane pishinave) ne qytetin e Tiranës.

Objekti kryesor i veprimtarise se saj eshte aktiviteti ne fushen e prodhimit, transmetimit dhe ritransmetimit te programeve dhe informacioneve te cfaredo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablove, perseritesave. Sateliteve apo me cdo mjet tjeter.

Ne vendimin e gjykates eshte parashikuar financimi i shoqerise nepermjet reklamave dhe sponsorizimeve ne perputhje me sa parashikon legjislacioni ne fuqi,etj.

Administrimi, Vleresimi i mbajtjes se kontabilitetit

Shoqeria drejtohet nga Drejtori i shoqerise "5 Shqipetar" sh.a. qe eshte administratori i saj dhe ortaku i vetem i shoqerise dhe i rregjistruar ne dokumentacionin e krijimit te saj, i cili ndjek dhe menaxhon aktivitetin e perditeshem te saj.

Kontabiliteti mbahet me dore nga kontabel i miratuar i cili kryen rregjistrimet kontabile ne libra e ditare etj. sipas rregullave kontabel. Ai eshte mbajtur sipas kerkesave te Ligjit "Per Kontabilitetin", te "Planit Kontabel te Pergjithshem" dhe te akteve te tjera ligjore e nenligjore ne fuqi.

Artikulli kontabel i celjes se llogarive ne fillim te vitit eshte bere sipas bilancit te mbylljes se vitit 2006 te shoqerise.

Per ushtrimin e mbyllur kam verifikuar shifrat e vendosura ne aktiv dhe pasiv te bilancit dhe kam konstatuar se jane te barabarta me kontabilitetin dhe me bilancin verifikues (gjendjet financiare te llogarive me 31.12.2007).

Cdo element i aktivitetit dhe pasivit eshte ne postin e vet dhe llogarite e reflektuara ne bilanc, rakordojne me shifrat e pasqyruara ne anekset e tij.

Nga mbledhja e shumave te kollonave te bilancit del qe ai eshte i rakorduar dhe ka nje shume prej 22.296.005 leke si ne aktivin dhe pasivin e tij.

Vleresimet jane bere me cmimet e blerjes, me cmimiet e shitjes dhe me vlera te faturuara te sherbimeve te ndryshme sipas dokumentave justifikuese, etj.

Blerjet dhe shitjet jane bere nepermjet arkes me leke ne dore (CASH) dhe nepermjet bankes ne vartesi te transaksionit te kryer.

Veprimet ne kontabilitet mbeshteten ne dokumentat justifikuese si fatura, liste pagesa, mandat arketimi e mandat pagese, fatura tatimore , inventare, etj.

-Kushtet e ruajtjes se dokumentave jane te mira.

-Aktiviteti financiar eshte ngurtesuar me 31.12.2007.

Shenime per LLogarite e Vitit 2007

Pas verifikimit te llogarive dhe sistemimeve te bera ne mbyllje te bilancit, rubrikat dhe postet per te gjithë grupet e bilancit rezultojne:

1 – Aktivet e Qendrueshme

Shoqeria e Juaj ka 20.536.780 leke aktive te qendrueshme ne total pas zbritjes se amortizimi te tyre.

Keto jane:

Aktive te Qendrueshme te Trupezuara 20.536.780 leke sipas vleres kontabel te tyre pas zbritjes se amortizimeve te mbartura dhe te llogaritura 8.625.294 leke.

Te shprehura me kosto historike keto aktive kapin vleren 29.162.074 leke, ato jane te evidetuara sipas strukturese se tyre.

Vleresimet e tyre jane me koston historike.

Gjendja ne bilanc korespondon me inventarin fizik te tyre. Keto aktive perbehen nga:

-*Instalime teknike, makineri e paisje* 29.162.074 leke

Gjate vitit A.Q.T. kane pesuar keto ndryshime:

-Jane blere 10.740.050 leke makineri e paisje teknike e elektronike per studiot televizive.

-*Amortizimet* ne total jane 8.625.294 leke i cili per ushtrimin eshte shtuar 5.141.694 leke nga amortizimi i llogaritur ne mbyllje te bilancit. Ka nje diference 360.000 leke ne amortizimin e mbartur ne kolonen e bilancit "Ushtrimi paraardhes"

2 - Aktive Qarkulluese

Shoqeria juaj ka patur ne dispozicion ne 31 dhjetor 2007 gjithsej 1.759.225 leke me nje paksim 5.010.750 leke nga fillimi i vitit.

Keto aktive perbehen nga:

-**Kerkesa per arketim** mbi debitoret 1.424.739 leke qe eshte shuma e **tatim fitimit** te paguar paradhenie gjate viteve. Gjate ketij viti eshte shtuar 238.927 leke.

-**Likuiditete**, me 31 dhjetor 2007 shoqeria ka 334.486 leke gjendje ne llogarine rrjedhese bankare, ndersa gjendje arke (leke ne dore) nuk ka.

3 - Kapitalet e Veta

Kapitalet e veta te shoqeria me 31.12.2007 jane 8.277.625 leke me nje shtese nga fillimi i vitit prej 1.254.146 leke, aq sa eshte dhe fitimi neto i kontabilizuar (bilancit) per ushtrimin.

Keto kapitale perbehen nga:

a-Kapitali themeltar i nenshkruar 3.895.697 leke, pa ndryshime gjate vitit.

b-Fitime te mbartura jane 681.938 leke, fimi i vitit 2006 i pa shperndare.

c-Fitime te ushtrimit jane ne bilanc 1.254.146 leke pas zbritjes se tatim fitimit te llogaritur 313.537 leke.

Shtoj ketu qe ne vendimet e gjykates dhe ne regjistrin tregetar kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke. Duke u nisur nga kjo situatë **sygjeroj** qe te kryhen veprimet e duhura ne regjistrin tregetar sipas legjislacionit ne fuqi .

4-Detyrime

Shoqeria juaj me 31 dhjetor 2007 ka patur 14.018.380 leke detyrime me paksim nga fillimi i vitit 306.540 leke.

Keto detyrime perbehen nga:

-**Furnitore** per blerje e sherbime 8.351.482 leke te cilet jane paksuar 374.762 leke.

-**Sigurime shoqerore** e shendetesore 91.907 leke te pa paguara deri me 31.12.2007.

-**Shteti – tatim taksa** 16.936 leke qe eshte TAP i pa paguar deri me 31.12.2007.

-**Ortake** jane 5.558.055 leke te cilet nuk kane levizje gjate vitit.

Verifikimimi i Llogarise se Humbjeve dhe Fitimeve.

Nga verifikimet e bera llogarine e Fitimeve dhe Humbjeve kemi konstatuar se te dhenat jane te njejtat me kontabilitetin dhe se shpenzimet jane marre nga saldot e llogarive te klases 6 dhe te ardhurat nga llogarite e klases 7 dhe ne nxjerrje te rezultatit jane trasferuar te ardhurat dhe shpenzimet.

Kjo pasqyre financiare paraqitet:

A - Shpenzimet: Shoqeria juaj gjate vitit 2007 ka bere gjithsej 15.831.729 leke shpenzime.

Sipas natyres se tyre ekonomike dhe kerkesave te formularit shpenzimet ndahen:

1-**Furnitura, nentrajtme dhe sherbime** 5.130.292 leke nga te cilat jane pagesa e shpenzime per blerje energji elektrike, karburante, p.t.t. etj shpenzime te pa stokueshme.

2-**Shpenzime per personelin** 3.340.203 leke, nga te cilat per paga jane shpenzuar 2.744.638 leke dhe per sigurime shoqerore e shendetesore 595.565 leke.

3-**Tatime, taksa e derdhje te ngjashme** 600.000 leke te paguara per KKRT e te tjera shpenzime te kesaj natyre.

4-Shpenzime te tjera rrjedhese 1.202.466 leke qe jane shpenzime per qera objekti dhe antene.

5-Amortizimi i llogaritur 5.141.694 leke me norma 20 dhe 25 % (paisjet elektronike).

6-Shpenzime financiare 17.074 lek sherbime bankare.

B - Te Ardhurat: qe ka realizuar shoqeria juaj gjate ketij vitit jane 17.399.412 leke leke Keto te ardhura rrjedhin nga :

-Nga **"Te rtjera shitje e sherbimeve"** 17.399.412 leke nga reklamat e ndryshme, prone televisive etj. shitje e sherbime.

C – Rezultati i Ushtrimit: Nga sa me siper rezulton:

-Shpenzime gjithsejt	15.831.729 leke
-Te ardhurat ne total	17.399.412 leke
-Rezultati ushtrimit	1.567.683 leke qe fitimi para tatimit.
-Fitimi i tatueshem	1.567.683 leke
-Tatim fitimi i llogaritur	313.537 leke

Shpenzime te panjohura nuk ka te evidentuara.

Anekse te Tjera te Llogarive Vjetore

Anekset tjera te llogarive vjetore si pjese perberese te Bilancit:

-Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve te Qendrueshme.

-Pasqyra e Amortizimeve.

-Skadenca e Kerkesave Debitore dhe Detyrimeve.

-Detajimi i Shifres Neto te Afarizmit.

-Rezultati Tatimor.

-Caktimi i Fitimit.